



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

PËR

PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **TË TRE ANËTARËVE PËR KËSHILLIN MBIKËQYRËS** **TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

- Znj. Suela Popa;
- Znj. Edlira Luçi;
- Z. Ridvan Bode.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË TRE ANËTARËVE PËR KËSHILLIN MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË”

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës, për realizimin e detyrave të ngarkuara, duhet të vlerësojë periodikisht situatën ekonomike, përfshirë politikën monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore.

Të gjithë anëtarët e këtij Këshilli emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në bazë të propozimeve konkrete të disa institucioneve.

Në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, të drejtën e propozimit për tre nga këta anëtarë e ka Këshilli i Ministrave, mbështetur në performancën dhe gjykimin objektiv të përzgjedhjes së disa prej kandidaturave të përshtatshme për të kryer detyrën e anëtarit të këtij këshilli.

Me shkresën nr.3599/1 prot., datë 16.11.2011, të Kuvendit të Shqipërisë, është përcjellë në adresë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave kopje e njoftimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me shkresë nr.5565 prot., datë 13.11.2018, ku bëhemi me dije se që nga data 3 nëntor 2018 u ka mbaruar afati i qëndrimit në detyrë gjashtë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Të gjashtë anëtarët janë zgjedhur prej Kuvendit të Shqipërisë me vendimet nr.135-138, datë 3.11.2011, vendimin nr.36, datë 26.2.2015; si dhe vendimin nr.53, datë 22.7.2016.

Për sa më lart, Këshilli i Ministrave duhet të propozojë 3 (tri) kandidatura që zëvendësojnë këta anëtarë:

1. Z. Petraq Milo (votuar më 3 nëntor 2011);
2. Znj. Elisabeta Gjoni (votuar më 3 nëntor 2011);
3. Znj. Denada Prifti (votuar më 24 dhjetor 2014, por ka mandat plotësues, të Ardian Fullanit si anëtar i Këshillit, votuar më 3 nëntor 2011).

Pavarësisht nga data e njoftimit të marrë, sa më sipër, nëpërmjet Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministria, me qëllim dhënien e kohës së mjaftueshme për kryerjen e procesit të përzgjedhjes së kandidaturave, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, në datën 19 shtator 2018, ka shpallur në “Njoftim për aplikim”, për paraqitjen e interesit prej cilido kandidat që vlerëson se përmbush kriteret ligjore dhe zotëron aftësitë profesionale për kryerjen e funksionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në “Njoftim për aplikim”, Këshilli i Ministrave inkurajon personat që përmbushin kriteret të aplikojnë. Konkretisht,

“Aplikanti duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

1. Të ketë:

- a) arsimin e lartë ekonomik ose juridik;
- b) përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare;
- c) kualifikime profesionale të profilit;
- ç) përvojë pune mbi pesë vjet në administratën publike ose në institucionet financiare dhe bankare.

2. Të mos ketë pengesat e mëposhtme:

- a) është dënuar nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;
- b) është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose është deklaruar i falimentuar dhe nuk është rehabilituar;
- c) është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshtërinë;
- ç) gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.

Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të deputetit në Kuvend, të anëtarit të Këshillit të Ministrave, si dhe të punonjësit, të administratorit dhe të aksionarit, me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë.”.

Gjithashtu edhe

“Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:

- **Kërkesë për aplikim;**
- Kopje e letërnjoftimit;
- *Curriculum Vitae* në gjuhën shqipe;
- Dokumente të diplomimit dhe të kualifikimeve profesionale të kërkuara;
- Dokument që të provojë vjetërsinë në profesion;
- Formular të plotësuar e të firmosur të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, në përputhje me ligjin nr.138/2015, të ndryshuar;
- Vetëdeklarim se nuk është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose deklaruar i falimentuar;
- Vetëdeklarim se nuk është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshtërinë;
- Vetëdeklarim se gjatë ushtrimit të detyrës nuk merr pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike.

(Deklarimi i rremë, përveç përgjegjësisë penale sipas ligjit, sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.).”

Pas shpalljes së njoftimit, në adresë të Kryeministrit, kanë paraqitur interes për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë rreth 38 kandidatë. Nga personat që kanë paraqitur interes janë përzgjedhur tri kandidaturat më të spikatuara, të cilat do t’i propozohen Kuvendit të Shqipërisë për t’u emëruar anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, konkretisht:

- Znj. Suela Popa;
- Znj. Edlira Luçi;
- Z. Ridvan Bode.

Në përzgjedhjen e kandidatëve është bërë kujdes i veçantë që Banka e Shqipërisë të mbahet larg nga militantët e partive politike dhe aty të emërohen njerëzit më të aftë, njohës të fushës e të sektorit bankar.

Znj. Suela Popa është arsimuar në Universitetin e Tiranës dhe është diplomuar me rezultate të shkëlqyera në dy fakultete, Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik, në shkencat juridike dhe ekonomike. Ka një eksperiencë të gjatë

disavjeçare (2007-2013) në ushtrimin e profesionit pranë Bankës së Shqipërisë. Ndërsa në vitet 2013-2017 ka qenë Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (ABZHR). Ajo ka kryer edhe një tërësi seminaresh dhe trajnimesh që i përkasin sektorit bankar.

Znj. Edlira Luçi është diplomuar në “Facolta di Economia e Commercio”, “Universita degli studi di Bari” Bari, Itali; ka kryer studime të thelluara pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti Financës dhe në vitin 2005 ka përfunduar studimet e ka fituar gradën “Doktor i shkencave” në fushën e ekonomisë, ndërsa në vitin 2011, gradën “Profesor i Asociuar”. Prej shumë vitesh znj. Luçi ka ushtruar funksione të rëndësishme shtetërore dhe si anëtare e bordeve drejtuese të institucioneve e organizmave financiarë shtetërore.

Z. Ridvan Bode është diplomuar për financë dhe në vitin 1995 ka përfunduar ciklin e thelluar të studimeve pasuniversitare në Montpellier, Francë, dhe ka fituar titullin “Master of Science”, në opsionin “Kërkim Shkencor” me vlerësimin “Cum Maxima Laude”. Gjithashtu, në vitet 1992-1993: Montpellier, Francë, “Diplome de specialisation Post Universitaire” (DSPU), me vlerësimin “Cum Maxima Laude”. Në vitet 1996-1997 dhe 2005-2013 ka qenë ministër i Financave dhe në legjislaturat III, V, VI, VII dhe VIII deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Më hollësisht, njohuritë dhe përvoja e kandidatëve reflektohet në CV-të personale, që i bashkëlidhen këtij relacioni.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 44, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1996, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, paraqitet për miratim projektvendimi “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të tre anëtarve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

KËSHILLI I MINISTRAVE